



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES/VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHendetesisë/PROSTAVNO ZDRAVJE/MINISTRY OF HEALTH	
Nësis Org. Org. Jedinica Org Unit	09
Nr. Prot. Br. Prot. Prot.No.	05-1120
Nr. faqeve Br. stranica No. pages	- 22 -
Data: Datum: Date:	14/02/2025
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

KONTRATË

“Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas”

Lot 2

(Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Drenas)

Numri i kontratës¹: **206-24-6057-2-2-1/C793**

Operatori ekonomik: **N.N.SH. " Vizion Project "**

NUI: 810540345

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

KONTRATË

Numri i kontratës²: 206-24-6057-2-2-1/C793

MINISTRIA E SHËNDETËSISË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

N.N.SH. " Vizion Project ", K.e Diellit Bl. IV H.IV, PRISHTINË, 600278370, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas me numër identifikues: 206-24-6057-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas

Nr.	Shërbimi - Punimet	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
2	Lot 2 - Menaxhimi dhe Mbikëqyrja profesionale e punimeve ndërtimore për ndërtimin e QKMF-së në Drenas, për të gjitha fazat ndërtimore. Sipas Specifikimeve teknike të detyrueshme në Aneksin 1 të DT dhe Kërkesat e obligueshme për menaxhimin dhe mbikëqyrjen profesionale të projektit sipas Ligjit të ndërtimit.	m2 (komplet objekti)	4,235.21 m2	6.50 €	27,528.87 €

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **27,528.87 €**; [Njëzeteshtatë mijë e pesëqindnjëzetetë Euro e tetëdhjeteshtatë cent].

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- Garancioni i ekzekutimit;

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

² Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.





4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Furnizuesin

Emri:	Berat Marmullaku	Emri:	PERPARIM OSMANI
Pozita:	Udhëheqës i Div. te Prokurimit	Pozita:	MENAXHER
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.02.2025	Data:	14.02.2025
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 206-24-6057-2-2-1/C793

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “**Ofrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe

Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga

konsorciumi që të veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbris dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdojë të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e

pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e

mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmspërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmspërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 206-24-6057-2-2-1/C793

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Neni	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e fillimit të Shërbimeve është: Me fillimin e kryerjes së punëve ndërtimore nga kontraktori i punëve. Koment: Në rast se nuk implementohet kontrata e punëve, nuk implementohet as kontrata e mbikëqyrjes.
	6.4	Data e Përfundimit është: Me pranimin teknik të punëve ndërtimore, por me se gjati 36 muaj nga data e fillimit të implementimit të kontratës.

		Koment: Ne rast se nuk implementohet kontrata e punëve, nuk imlementohet as kontrata e mbikëqyrjes dhe AK nuk obligohet ndaj kompanisë mbikëqyrëse, përveç vlerës se punëve te mbikëqyrura.
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është: QKMF ne Drenas
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është: Caktohet me vendim nga ZKA i MSH-se.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% e kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% e çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës se kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 37 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë:
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Pagesat bëhen paralelisht me përqindje (%) te pagesave për punët e paguara. Vlera e kontraktuar për mbikëqyrje është për komplet sipërfaqen përkatëse te objektit. Lot 2 QKMF ne Drenas - Total sipërfaqja ndërtimore bruto: 4,235.21 m2
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Sipas Planit për Menaxhim te Kontratës. Periudha Garantuese e Defekteve është: 12 muaj.
Zgjidhja e miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministrisë se Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME

Menaxhimi dhe Mbikeqyrja profesionale e realizimit te punimeve ne projektet per realizim - ndertim:

Lot 2 - Objekti i Qendres Kryesore te Mjekesise Familjare (QKMF) ne Drenas

Pershkrimi i Projektit:

Objekti i Qendrës Kryesore te Mjekësisë Familjare (QKMF) në Drenas, parashihet të ndërtohet ne Drenas, në pronën e QKMF-se ekzistuese si objekt i ri, me etazhitet B+P+1. Sipërfaqet (bruto) ndërtimore parashihen te janë:

Bodrumi (bruto sip. ndërtimore) : 837.33 m2

Përdhese (bruto sip. ndërtimore) : 2208.98 m2

Kati 1 (bruto sip. ndërtimore) 1188.90 m2

Total sipërfaqe ndërtimore bruto: **4235.21 m²**

Vlera e kontraktuar e punëve është: **2,929,292.92 euro**

Kërkesat e obligueshme për Operatorin ekonomik - ofruesin e shërbimeve - Pajisjet dhe operative ne Menaxhim dhe mbikëqyrje

Pajisjet:

Ndërmarrja mbikëqyrëse është e obliguar që për punishten ne QKMF Drenas te siguroj hapësirë pune në sipërfaqe neto min. 12m² — zyre mbikëqyrëse ne punishte. Zyra mbikëqyrëse ne punishte duhet në vete të përmbajë minimumin e pajisjeve:

- Hapësirë komode për punë, me izolim termik, hidro - izolim, ndriçim natyror dhe artificial, qasje në rrjetin elektrik pa ndërprerje, ngrohje, ventilim dhe klimatizim,
- Karrige pune dhe tavolina pune për stafin mbikëqyrës, stafin menaxherial dhe takimet e përbashkëta,
- Një printer Color, min. format A3 ne gjendje permanente pune,

Kërkesat operative:

- Menaxhimi (mbikëqyrja) i kontratës do të realizohet në pajtim të plotë me Ligjin për prokurimin Publik (LPP), Rregullorën 001/2022 për Prokurim Publik (RrPP) - Kapitulli i V-të - Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i performancës së kontraktuesve, ligjin e Ndërtimit dhe legjislacionin sekondar të dalë nga ky ligj, si dhe ligjet dhe rregullat e fushave specifike sipas fushëveprimit të projekteve;
 - Kontraktuesi - ofruesi i shërbimeve për menaxhimin e kontratës është i obliguar të propozoj/emëroj ekipin/stafin profesional për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen profesionale (pjesë e ekipit) me kërkesë të Autoritetit kontraktues për secilën fazë të ndërtimit, të njoftoj me shkrim AK-në për propozimin e tillë dhe të marrë aprovimin nga AK;
 - Ekipi për Menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen profesionale bartin përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen profesionale/verifikimin e secilës fazë të punëve ndërtimore konform legjislacionit në fuqi;
 - Mbikëqyrja profesionale e realizimit të punimeve ndërtimore nga Kontraktuesi - ofruesi i shërbimeve, bëhet si mbikëqyrje e afërt ne harmoni dhe pajtim të plotë me Ligjin e Ndërtimit, legjislacionin sekondar, LPP-në, RRPP-në, ligjeve dhe rregullave tjera në fuqi që rregullojnë fusha të caktuara sipas fushëveprimit të projekteve, duke u bazuar ne projektin kryesor për realizim - dokumentacionin tekniko - investiv për realizim, specifikat teknike dhe Paramasën dhe parallogarinë e kontraktuar të projektit, kontratën e punëve për ndërtimin e objekteve e lidhur mes AK (MSH) dhe OE (punekryesit), duke u bazuar ne LPP dhe Legjislacionin sekondar;
- Ofruesi i shërbimeve-kontraktuesi do te jete bashkë-përgjegjës për procedim të rregullt të Librit ndërtimor, Ditarit ndërtimor dhe tërë dokumentacionit rrjedhës teknik ne përcjellje te realizimit te punimeve në teren në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Ofruesi i shërbimeve-kontraktuesi do te jetë i obliguar që në bashkëpunim të plotë profesional me punëkryesin, projektuesin dhe autoritetin kontraktues (AK) te gjejë zgjidhje alternative nëse kjo do jetë e nevojshme gjatë realizimit të punimeve - gjithnjë ne harmoni me ligjin e ndërtimit dhe LPP dhe nevojat specifike ne lokacion - sipas termave dhe kushteve të kontratës ne mes te AK dhe punë kryesit;

Funksionet dhe përgjegjësitë e MK/EMK:

- a) Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, udhëheqësi i ekipit për menaxhimin e kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i kontratës brenda afatit duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- b) Udhëheqësi i EMK-se në pajtim me rregullat e prokurimit publik duhet të menaxhojë kontratën në sistemin e prokurimit elektronik, moduli "Menaxhimi i Kontratës";
- c) Menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- d) Sigurojë që Operatori Ekonomik përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dergesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- e) Sigurojë që Operatori Ekonomik dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- f) Sigurojë që autoriteti kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës (aprovimit, certifikimit dhe kontrollit të pagesave);
- g) Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës;
- h) Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së Kontratës;
- i) Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik;
- j) Bëjë vlerësimin e performancës së operatorit ekonomik në sistemin e prokurimit elektronik pas përfundimit të kontratës;
- k) Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës dhe legjislacionin për natyrën e aktivitetit;
- l) Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit e a merr miratimin;
- m) Të menaxhojë dorëzimin dhe procedurat e pranimit;
- n) Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- o) Dorëzojë raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Përgjegjësitë dhe funksionet shtesë të anëtarëve të Ekipit për menaxhimin e kontratës /mbikëqyrjen profesionale, janë:

- a) Që të bëjnë mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës dhe të përkujdesen për ekzekutimin e kontratës sipas kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike dhe dispozitave ligjore relevante në fuqi;
- b) Të sigurojnë se secila fazë perkatese e ndërtimit të verifikohet dhe ka kontroll të vazhdueshëm në aspektin cilësor, sasisë dhe kohës në pajtim me specifikimeve teknike;

- c) Të sigurojnë se ka kontroll të vazhdueshëm të materialeve dhe pajisjeve të përdorura në projekt në përputhje me specifikimet teknike;
- d) Të hartojnë raporte në lidhje me verifikimin dhe aprovimin e punëve ndërtimore dhe pagesave;
- e) Mbikëqyrësi i punimeve në Çdo moment që vëren devijim nga termat, kushtet dhe specifikimet e kontratës duhet ta njoftoj Autoritetin Kontraktues dhe të marrë veprimet e duhura për ti raportuar dhe ndaluar ato;
- f) Mbikëqyrësi i punimeve merr përgjegjësinë e përcjelljes dhe kontrollit të vazhdueshëm në baza ditore, realizimin e kontratës dhe aktiviteteve të projektit konform kushteve të kontratës detyrave dhe përgjegjësi të deleguara nga AK sipas ligjit ndërtimit, LPP-së legjislativitetit sekondar, ligjeve dhe rregullave tjera në fuqi sipas fushëveprimit të projektit;
- g) Mbikëqyrësi i punimeve gjatë realizimit të projekteve duhet që njëkohësisht të përcjellë afatet kohore të realizimit të kontratës konform planit dinamik të aprovuar nga AK;
- h) Mbikëqyrësi i punimeve merr përgjegjësinë e verifikimit dhe përcjelljen e marrjes të masave për siguri dhe shëndet në punë gjatë realizimit të projekteve nga punë kryesi;
- i) Mbikëqyrësi i punimeve duhet të përcjellë dhe monitoroj procesin e marrjes së mostrave në vend dhe aprovimin e certifikatave të materialeve për aprovim;
- j) T'i raportojnë udhëheqësit të Ekipit për menaxhim të kontratës.

Komunikimi:



- Mënyra dhe forma e komunikimit me punë kryesin të jetë në baza ditore, takime, në formën e shkruar dhe komunikime verbale me mbështetje në formën e shkruar, shkresa elektronike etj. (Komunikimi me shkrim do merret në konsideratë tek rendi i përparësive);
- Komunikimi me Autoritetin Kontraktues (AK) - Takime, në formën e shkruar përmes komunikimit elektronik apo me shkresa si kopje e forte, shkresat duhet të jenë të konfirmuara nga të dyja palët;
- Çdo kërkesë e dhënë ndaj punë kryesit ose AK duhet të dokumentohet me shkrim pranë palëve të interesit - AK, OE - punë kryesit dhe palëve tjera;
- Mënyra e Raportimit të AK - Me raporte javore, Raport final dhe raporte të jashtëzakonshme;
- Takimet e punës me punë kryesin - në baza ditore;
- Takimet e punës me AK - sipas nevojës dhe obligative në baza javore sipas kërkesës së AK.

Shënim:

1. Shërbimi i menaxhimit dhe mbikëqyrjes profesionale të realizimit të punimeve, pos të gjitha punimeve ndërtimore në objekt në kuadër të çmimit të dhënë (e) përfshin të gjitha punimet e kontraktuara në parter, volumn dhe natyrën e të cilave ofertuesit rekomandohet të informohet përmes qasjes fizike në dokumentacionin teknik në MSh (zyrën e Prokurimit),
2. Shërbimi i mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollet është e obliguar të ofrohet në baza ditore në orar të plotë— mbikëqyrje e afërt,
3. Metodologjia e pagesës së shërbimit të mbikëqyrjes realizohet mbi bazën e (0/0) përqindjes së realizimit të punimeve në teren — bazuar në raportet e realizimit për secilën fazë ndërtimore, Menaxherit të Kontratës/Ekipi për Menaxhimin e Kontratës.

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Lot	Shërbimi - Punimet	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
2	Lot 2 - Menaxhimi dhe Mbikëqyrja profesionale e punimeve ndërtimore për ndërtimin e QKMF-së në Drenas, për të gjitha fazat ndërtimore. Sipas Specifikimeve teknike të detyrueshme ne Aneksin 1 të DT dhe Kërkesat e obligueshme për menaxhimin dhe mbikëqyrjen profesionale të projektit sipas Ligjit të ndërtimit.	m2 (komplet objekti)	4,235.21	€ 6.50	€ 27,528.87

Identifikim i operatorit ekonomik (oe)	
Emri i oe:	N.N.SH VIZION PROJECT
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të oe:	SHKELQIM OSMANI
Nënshkrimi:	
data:	08.07.2024
vula:	

AUTORITETI KONTRAKTUES

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ZAGREBIT , P.N., -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 206-24-6057-2-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: N.N.SH. " Vizion Project ", K.e Diellit Bl. IV H.IV, 10000, PRISHTINË, Kosovë

E-mail: vizionproject@yahoo.com

Personi kontaktues: Shkelqim Osmani

Telefoni: 045 222 888

Faxi:

Numri fiskal: 600278370

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 206-24-6057-2-2-1

Titulli i kontratës: Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

2 Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Drenas

3. Çmimi total i tenderit është:

27,528.87 EUR

Dhe në fjalë [*shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro*]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [*shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet*] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [*shëno emrin e udhëheqësit*]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK
8. Thaksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

MENAXHER I KONTRATËS

Nr	Emri dhe Mbiemri	Përgatitja Profesionale	Pozicioni ne kompani	Përvoja ne vite
1	SHKËLQIM OSMANI	INXH. I DIP. I ARKITEKTURËS	MENAXHER I PROJEKTIT	18 VITE

LISTA E STAFIT PROFESIONAL

Nr	Emri dhe Mbiemri	Përgatitja Profesionale	Pozicioni ne kompani	Përvoja ne vite
2	SEDAT AHMETI	MA.SC. I DIP. I NDËRTIMTARISË - KONSTRUKTIV	Projektant i Strukturave	7 VITE
3	LAVDIM OSMANAJ	INXH. I DIP. I HIDROTEKNIKËS	Projektant i Instalimeve Hidrosanitare	18 VITE
4	PETRIT KASTRATI	MASTER I SHKENCAVE TË INXHINIERISË ELEKTRIKE	Projektant i Instalimeve Elektrike	5 VITE
5	AFRIM DEMIRI	INXH. I DIP. E ELEKTROTEKNIKËS	Projektant i Elektroteknikës	11 VITE
6	AMIR ARIFI	MA.SC. I MAKINERISË	Projektant i Instalimeve Makinerike	6 VITE
7	ZEKIRJA ELEZI	INXH. I DIP. I GJEODEZISË	Inxhinier i Gjodezisë i Licencuar	25 VITE

**N.N.SH "VIZION PROJECT"
PRISHTINE**



DATA: 08.07.2024
VENDI: PRISHTINË

DEKLARATA E MENAXHERIT TË PROJEKTIT

Kompania N.N.SH "VIZION PROJECT" nga Prishtina cakton menaxher të projektit z.Shkelqim Osmani me profesion Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës për tenderin me titull :

Autoriteti Kontraktues: MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Titulli: Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas "Ri-projektimi i Spitalit të Përgjithshëm të Ferizajt"


Numri i Prokurimit: 206-24-6057-2-2-1

z.Shkelqim Osmani me pervoj pune 18 vjeqare me titull Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ka qene menagjer i mbikëqyrjes së projekteve të ndryshme qe ka bërë kompania N.N.SH "VIZION PROJECT" te cilat i ka përfunduar me afat të parapar sipas autoritetit kontraktues.

N.N.SH "VIZION PROJECT"



Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës
Shkelqim OSMANI





Numri i Prokurimit: 206-24-6057-2-2-1

Titulli: "Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas"

Aneksi 1 DEKLARATË MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [N.N.SH VIZION PROJECT] deklaroj se do të përmbush të gjitha detyrat e dhëna në Specifikimet Teknike të Detyrueshme dhe se do të zbatoj ato me përgjegjësi të plotë ligjore dhe se do të përmbahem detyrave të dhëna në keto specifikime.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	N.N.SH VIZION PROJECT
Adresa e plotë:	Rr.Ukshin Kovaçica LI-3, LI-C, Nr.1 Prishtinë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	SHKELQIM OSMANI
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	08.07.2024
Vula:	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE NE KOSOVE
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810540345

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Shkelqim Osmani B.I.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

N.N.SH. " Vizion Project "

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit: Biznes individual
Poslovni tip: Individualno preduzeće
Business type: Individual business

Adresa: Rruga Ukshin Kovaçiva , Ll.3, Ll-C Nr.1
Adresa: Prishtinë
Address:

Data e regjistrimit: 03/03/2008
Datum registracije:
Date of registration:

21/08/2023

Data / Date / Datum



Nënskrim / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10170384



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **136032**

Për **Ministria e Shëndetësisë**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Shkelqim Osmani B.I.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas**

Nr. prokurimit: 206-24-6057-2-2-1/C793 , Nr. brendshëm: 206-24-6057-2-2-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t' i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **2,752.88€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmimeve të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **2,752.88€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1125 ditë kalendarike prej **14.02.2025** deri më **15.03.2028**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 14.02.2025

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.